

GJYKATA THEMELORE E PRISHTINËS

Mbajtur në Gjykatën e Apelit në Prishtinë

Numri i lëndës: **PKR 276/13**

Datë: **19 korrik 2013**

Aktgjykimi i publikuar mund të mos jete i formës së prere dhe munde të jetë objekt i ankesës në baze të ligjit të aplikueshëm.

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE E PRISHTINËS, në trupin gjykues të përbërë nga gjyqtarja e EULEX-it, **Mariola Pasnik**, si kryetare e trupit gjykues, gjyqtari i Republikës së Kosovës **Faik Hoxha** dhe gjyqtarja e EULEX-it, **Franciska Fiser**, si anëtarë të trupit gjykues, me pjesëmarrjen e zyrtarit ligjor të EULEX-it, Grzegorz Lewocki, si procesmbajtës, në lëndën penale kundër:

N.B., me nofkat “Gj.” dhe “S.”, emri i babait I., emri i nënës N., i lindur më x xx xxxx në xxxxx, Komuna e xxxxx, shqiptar i Kosovës, me numër të letërnjoftimit xxxxxxxxx, i martuar, tre fëmijë.

I akuzuari N.B. është akuzuar sipas Aktakuzës së Prokurorit Special të EULEX-it, Maurizio Salustro, i Prokurorisë Speciale të Republikës së Kosovës (PSRK), PPS 460/09, datë 26 prill 2013, dhe e ngritur në gjykatë në të njëjtën ditë, për veprat penale si në vijim, të ndjekura sipas detyrës zyrtare:

N.B., i akuzuar për veprën penale të vrasjes së rëndë, në shkelje të nenit 30, paragrafët 1 dhe 2, të Ligjit Penal të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës (KPKSAK), lidhur me nenin 22 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KPRSFJ), aktualisht e dënueshme nga nenet 31 dhe 179, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.4, të KPK-së, në bashkëkryerje me **S.A., B.S., Sh.U. dhe F.G.**, sepse ka vrarë **I.K.** duke e qëlluar për vdekje me disa plumba të një arme të zjarrit. Konkretisht, në natën e vrasjes grupi i bashkëkryerësve, përfshirë N. B., u afruan pranë shtëpisë së viktimës, njëri prej tyre trokiti në derë dhe kur viktimja doli jashtë, N.B. e qëllloi për vdekje me së paku 6 plumba të shtënë nga pistoletë Scorpion që i ishte dhënë atij nga njëri prej bashkëkryerësve. **Në Prishtinë më 6 gusht 1999;**

PAS mbajtjes më 3 korrik 2013 të shqyrtimit fillestar me dyer të mbyllura, përveç vëzhguesve të Qendrës Humanitare Ligjore në Kosovë, ku i pandehuri u vetë-deklarua fajtor; pas nxjerrjes më 3 korrik 2013 të aktvendimit se i pandehuri e pranonte vetë-deklarimin e fajësisë, dhe pas zhvillimit të shqyrtimit kryesor për të përcaktuar çështjen përkatëse për masën e dënimit, të mbajtur më 15 korrik 2013 në prani të të akuzuarit N.B., z. O.H., mbrojtësi i tij, z. Maurizio Salustro, prokuror special i EULEX-it në PSRK, dhe palës së dëmtuar, si dhe vëzhguesit nga Qendra Humanitare Ligjore e Kosovës;

PAS këshillimit dhe votimit të trupit gjykues, të mbajtur më 15 dhe 19 korrik 2013;

NË PAJTIM me nenin 3, paragrafi 2, të KPK-së, nenin 30, paragrafi 1 dhe paragrafi 2, të Ligjit Penal të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës (LPKSAK), lidhur me nenin 22 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KPRSFJ) dhe nenin 22 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.53, nenin 25 paragrafi 3, nenin 248 paragrafi 4, nenin 359 paragrafët 1 dhe 2, nenin 365 paragrafi 1, nën-paragrafët 1.1, 1.2, 1.3, 1.5 dhe 1.6 të Kodit të Procedurës Penale (KPP-së), të shpallur në Ligjin Penal nr. 04/L-123 më 13 dhjetor 2012, i hyrë në fuqi më 1 janar 2013;

Duke marrë gjithashtu parasysh bazat nga neni 42 paragrafi 2, neni 43 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KPRSFJ)

sot më 19 korrik 2013, në seancë publike dhe në prani të të akuzuarit, mbrojtësit të tij, prokurorit special të EULEX-it dhe vëzhguesit nga Qendra Humanitare Ligjore e Kosovës dhe pala e dëmtuar.

Shqipton këtë:

AKTGJYKIM

I Në pajtim me nenin 3 paragrafi 2 të KPK-së, nenin 30 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 të Ligjit Penal të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës (LPKSAK), lidhur me nenin 22 të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KPRSFJ), N.B., me shënimet personale të lartë-cekura, **SHPALLET FAJTOR** për vrasje të rëndë, sepse në bashkëkryerje me S.A., B.S., Sh.U. dhe F.G., ai vrau I.K. duke e qëlluar për vdekje me disa

plumba të armës se zjarrit. Koncretisht, në natën e vrasjes, grupi i bashkëkryerësve, përfshirë N.B., u afruan pranë shtëpisë së viktimës, njëri prej tyre trokiti në derë dhe, kur viktimë doli jashtë, N.B. e qëllloi për vdekje me së paku 6 plumba të shtënë nga pistoleta Scorpion, që iu dha atij nga njëri prej bashkëkryerësve. Në Prishtinë më 6 gusht 1999;

PRANDAJ:

II Në bazë të nenit 3 paragrafi 2 të KPK-së, nenit 30 paragrafi 1 dhe paragrafi 2 të Ligjit Penal të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës (LPKSAK) dhe nenit 42 paragrafi 2, nenit 43 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1, të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KPRSFJ), i pandehuri N.B.(me shënimet personale si më lart) dënohet me **katër (4) vjet dhe gjashtë (6) muaj burgim.**

III Në pajtim me nenin 365 paragrafi 1 nën-paragrafi 1.5 të KPP-së, koha e kaluar në arrest shtëpiak nga 30 nëntori 2009 deri në 29 nëntor 2010 do të llogaritet në dënim.

ARSYETIM

I. Historia procedurale:

1. **26 prill 2013** – u ngrit aktakuza nga Prokuroria Speciale e Republikës së Kosovës;
2. **28 prill 2013** – u caktuan kryetarja e trupit gjykues i EULEX-it dhe anëtarët e trupit gjykues të EULEX-it;
3. **14 maj 2013** – u caktua gjyqtari i Republikës së Kosovës nga Kryetari i GJTH të Prishtinës;
4. **16 maj 2013, 24 maj 2013 dhe 5 qershor 2013** – u caktua mbrojtësi sipas detyrës zyrtare, por nuk pranoi ta mbronte të pandehurin;
5. **11 qershor 2013** – u caktua shqyrtimi fillestar (u shty për shkak të mungesës së mbrojtësit dhe të pandehurit);
6. **13 qershor 2013** – u caktua mbrojtësi sipas detyrës zyrtare në personin e Kryetarit të Dhomës së Avokatëve Prishtinë;
7. **3 korrik 2013** – u zhvillua shqyrtimi fillestar;

8. **15 korrik 2013** – u zhvillua seanca e shqyrtimit gjyqësor që vendosi lidhur me çështje relevante për shqiptimin e masës së dënimit;
9. **19 korrik 2013** – u bë shpallja e aktgjykimit.

II. Kërkesat e akuzës:

Prokurori kërkoi që i pandehuri të gjendet fajtor sipas aktakuzës: Ai tha gjithashtu se, kur të merrej aktgjykimi, duhej të merrej parasysh se, falë bashkëpunimit të vazhdueshëm të të pandehurit dhe bazuar në deklaratat e tij, ishin ngritur dy aktakuza kundër gjithsej 7 të pandehurve dhe ishin dhënë dy dënime fajësie nga gjykata e Kosovës. I pandehuri është shpallur dëshmitar bashkëpunues dy herë dhe dy herë u gjet se ishte dëshmitar bashkëpunues i besuar; i pandehuri tregoi pendim për ato që kishte bërë dhe u vetë-deklarua fajtor përpara kësaj gjykate. Akuza tha se në përgjithësi përfundimi i detyrueshëm ka qenë se, meqenëse i pandehuri kishte qenë bashkëpunëtor i drejtësisë, ai meritonte të pranoheshin rrethana lehtësuese dhe dënimi i tij të ulej, në mos në minimum, afër tij. Për më tepër, Prokurori tha se i pandehuri N.B., i cili gjatë viteve të fundit kishte pritur me durim dënimin e tij dhe kishte konfirmuar në mënyrë të përsëritur versionin fillestar të tij të fakteve dhe kishte përsëritur rrëfimet e veta, e meritonte këtë.

III. Kërkesa e të pandehurit:

Gjatë shqyrtimit fillestar më 3 korrik 2013, i pandehuri e konfirmoi akuzën dhe u vetë-deklarua fajtor për vrasjen e I.K. Në seancën e shqyrtimit gjyqësor që vendosi lidhur me çështje relevante për shqiptimin e masës së dënimit, më 15 korrik 2013, ai e konfirmoi sërish fajësinë e tij. Të pandehurit nuk i është mohuar asnjëherë përfshira në akuzën e përshkruar në aktakuzë.

IV. Kërkesa e mbrojtësit (1) dhe përmbledhja e shkurtër e tij e paraqitur në fjalën përfundimtare të tij (2):

1. **Mbrojtësi** kërkoi që trupi gjykues i shqyrtimit gjyqësor të marrë parasysh rrethanat lehtësuese që ishin prezent në anën e të akuzuarit dhe, kur të vendoste lidhur me dënimin, duhej të caktonte një dënim me burgim nën minimumin e parashikuar nga ligji.

2. Në argumentet e tij, mbrojtësi tha se pas nënshkrimit të “Marrëveshjes së Kumanovës”, me të cilën iu dha fund luftës në Kosovë, gjërat ndodhën në një shkallë të paparashikueshme, sepse situata nuk ishte ende nën kontroll. KFOR nuk i kishte kapacitetet për të mbuluar edhe pjesët civile; për rrjedhojë, popullata ishte nën eufori të madhe, jashtë kontrollit, çka vazhdoi për disa muaj më pas. Ai argumentoi se në atë kohë për një pjesë të popullatës, punonjësit dhe stafi i ish sistemit komunist ishin persona të padëshiruar dhe të urreyer. Në këto rrethana, ndodhi për fat të keq vrasja e I.K., i cili ishte inspektor policie në pension, i cili, për një kohë të gjatë pas kësaj daljeje në pension, i ishte kushtuar jetës civile dhe familjare të tij. Në këto rrethana, i pandehuri N.B. mendoi se duke vrarë të ndjerin I.K. po bënte një gjest patriotik. I pandehuri e paraqiti vetë rastin, përkatësisht; duke pranuar se e kishte kryer vrasjen, por edhe duke pranuar fajësinë për veprën e kryer, ai ka treguar nivel të lartë përgjegjësie morale dhe penale, dhe një pendim shumë të thellë përkatësisht. Ai i ka kërkuar ndjesë të thellë familjes së dëmtuar për gabimin e pamasë që ka bërë. Nisur nga pendimi i thellë i tij, kërkimi në vazhdimësi i ndjesës nga familja e dëmtuar, bashkëpunimi i tij me policinë dhe në veçanti me Prokurorin, por edhe me gjykatën, nisur nga fakti se ai është familjar, i martuar dhe prind i tre (3) fëmijëve, ky i akuzuar duhet të ketë shumë rrethana lehtësuese kur të merret vendimi për dënimin penal. Mbrojtësi tha se ishte thellësisht i bindur se trupi gjykues i shqyrtimit gjyqësor duhet të marrë parasysh veçanërisht rrethanat lehtësuese që u paraqitën në anën e të akuzuarit, dhe, kur të vendoset për dënimin, duhet të caktohet një dënim me burgim nën dënimin minimal të parashikuar nga ligji, pasi që ligji e parashikon këtë mundësi në raste të tilla. Krahas faktit se koha e kaluar nën arrest shtëpiak nga 30 nëntori 2009 deri më 30 nëntor 2010 duhet llogaritur në dënimin e caktuar, në këtë dënim duhet të llogaritet edhe koha pas 30 nëntorit 2010 e këtej, e izolimit të tij nën masa të rrepta sigurie të policisë së EULEX-it, çka do të thotë madje izolim të plotë nga jeta civile dhe e përditshme, e kërkuar nga Njësi i për Mbrojtje të Afërt, një marrëveshje që u nënshkrua nga Kryeshefi i EULEX-it, Xavier De Marnac, dhe i akuzuari.

V. Kërkesat e palëve të dëmtuara:

A.K. dhe **D.K.** informuan nga gjykata për të gjitha seancat në këtë lëndë. A.K. ishte prezent më 3 korrik 2013 dhe nuk paraqiti kërkesë. D.K. mungoi në të gjitha herët. Ajo nuk i dërgoi gjykatës ndonjë kërkesë.

VI. Dëshmitë dhe provat e administruara gjatë shqyrtimit gjyqësor:

1. Gjatë rrjedhës së shqyrtimit gjyqësor, trupi gjykues i shqyrtimit gjyqësor, me pëlqimin e palëve, i konsideroi si të lexuara këto deklarata:
 - A. Deklarata e të pandehurit N.B., e dhënë më 30 nëntor 2009;
 - B. Deklarata e të pandehurit N.B., e dhënë më 3 dhjetor 2009;
 - C. Deklarata e të pandehurit N.B., e dhënë më 3 korrik 2013¹.

2. Dëshmi dhe prova të tjera të vlerësuara nga gjykata:
 - A. Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut të Prishtinës në lëndën S.A. e të tjerët, i datës 17 dhjetor 2012 (P 592/11);
 - B. Proces-verbalet e seancave të shqyrtimit gjyqësor në lëndën S.A. e të tjerët, (P 592/11) të datave 3 dhe 27 shkurt 2012; 2, 8, 16, 20, 22, 29 mars 2012; 12, 13, 25, 26 dhe 27 prill 2012; 29, 30 dhe 31 maj 2012; 6, 7, 11, 13, 14, 18, 20 qershor 2012; 25, 26 dhe 27 korrik 2012; 6, 7, 10, 12 dhe 20 shtator 2012; 15, 17, 18, 22, 23 dhe 31 tetor 2012; 5, 7, 14, 15, 19 dhe 22 nëntor 2012 dhe 14 dhjetor 2012;
 - C. Raporti i Balistikës i përgatitur nga Laboratori i Krim-teknikës (seksioni i armëve të zjarrit dhe shenjave të veglave) më 2 shtator 2010, Laboratori, nr. ref. 2010-1576; PPS nr. 460/09;
 - D. Aktgjykimi i Gjykatës së Qarkut të Prishtinës në lëndën F.G.(P. Nr. 371/10), më 23 nëntor 2011;
 - E. Deklaratat e dëshmitarëve:
 - i. D.D. më 23 nëntor 2009;

¹ Seanca e shqyrtimit gjyqësor më 15 korrik 2013 f. 4.

- ii. A.S. më 3 dhjetor 2009;
- iii. B.B. më 31 dhjetor 2009;
- iv. O.B. më 2 korrik 2010;
- v. G.G. më 28 nëntor 2009;
- vi. G.G. më 13 shtator 2010;
- vii. G.G. më 28 prill 2011;
- viii. K.G. më 7 qershor 2011.

VII. Kompetenca dhe përbërja e trupit gjykues të gjykatës:

Në bazë të Nenit 20 paragrafi 1, Nenit 22 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.53, dhe Nenit 25 paragrafi 3, të KPP-së dhe Nenit 3 paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit për Juridiksionin, Përzgjedhjen e Lëndëve, Ndarjen e Lëndëve tek Gjyqtarët dhe Prokurorët e EULEX-it në Kosovë (Ligji Nr. 03/L-053), trupi gjykues i Gjykatës Themelore të Prishtinës ka juridiksion kompetent për të gjykuar lëndën.

Në këtë lëndë, akuza kundër të pandehurit është vepra penale e vrasjes së rëndë, prandaj Gjykata Themelore e Prishtinës ka juridiksion lëndor për ta gjykuar lëndën. Sipas aktakuzës, vepra penale u krye në Prishtinë, që është brenda territorit të Gjykatës Themelore të Prishtinës. Prandaj, në pajtim me Nenin 20, paragrafi 1, të KPP-së, Gjykata Themelore e Prishtinës ka juridiksion Gj. për ta gjykuar këtë lëndë.

Meqenëse lënda në fjalë iu caktua në kompetencë gjyqtarëve të EULEX-it me vendim të Përgjegjësit të Kontaktit të Njesisë së Lëvizshme të Gjyqtarëve të EULEX-it më datë 28 prill 2013 (PKR nr. 56/2013), trupi gjykues u përbë nga dy gjyqtarë të EULEX-it dhe një gjyqtar i Kosovës, në bazë të Nenit 3.7 të Ligjit për Juridiksionin, Përzgjedhjen e Lëndëve, Ndarjen e Lëndëve tek Gjyqtarët dhe Prokurorët e EULEX-it në Kosovë.

Asnjëra prej palëve nuk e kundërshtoi përbërjen e trupit gjykues.

VIII. Seancat e shqyrtimit gjyqësor:

Shqyrtimi fillestar i mbyllur për publikun u zhvillua më 3 korrik 2013. Seanca e shqyrtimit gjyqësor për të vendosur për çështje relevante për caktimin e dënimit u mbajt më 15 korrik 2013 dhe shpallja e aktgjykimit u krye më 19 korrik 2013, në prani të Prokurorit të EULEX-

it, Maurizio Salustro, të akuzuarit N.B. dhe mbrojtësit të tij O.H. Pala e dëmtuar A.K. ishte prezent vetëm më 3 korrik 2013, ndërsa D.K. nuk ishte prezent, megjithëse u thirr me rregull.

Në pajtim me Nenin 14 të KPP-së, përkthyesit ndërkombëtarë e përkthyen procedurën gjyqësore, si dhe të gjitha dokumentet e gjykatës relevante për shqyrtimin nga anglishtja në shqipe dhe anasjelltas, sipas nevojës.

IX. Gjetjet e gjykatës:

Përshkrimi i fakteve:

Pasi kishte monitoruar I.K.për një farë kohe paraprakisht, i pandehuri N.B., i cili ishte bashkë me F.G., S.A. dhe Sh.U. në mbrëmjen e 6 gushtit 1999 në Prishtinë, mori një armë zjarri të vogël të tipit Scorpion nga një veturë në të cilën ndër të tjerë ndodhej edhe A.S.. Pistoleta iu dha të pandehurit nga F.G. Pastaj N.B. me katër persona të tjerë (F.G., S.A., B.S. dhe Sh.U.) shkuan me veturë për në shtëpinë e të ndjerit I.K. në drejtim të Kodrës së Diellit. Sh.U. i udhëzoi të tjerët dhe qëndroi në veturë. Rreth orës 21.00, N.B., F.G., S.A. dhe B.S. shkuan në këmbë për tek gardhi përreth shtëpisë së I.K. Afër portës së vogël në hyrje të gardhit, ata u pozicionuan në rrugë, me S.A. në të djathtë të N.B., B.S. në të majtë të N.B. dhe F.G. prapa N.B. S.A. i kërkoi bashkëshortes së I.K., dëshmitarja dhe e dëmtuara D.K., të thërriste bashkëshortin e saj, sepse dëshironin të bisedonin me të. Kur I.K. doli jashtë portës dhe hyri në rrugë, N.B., pasi mori konfirmimin nga S.A. lidhur me identitetin e saktë, dhe duke përdorur pistoletën që kishte marrë, shtiu të paktën 6 plumba në drejtim të I.K. dhe me këtë shkaktoi vdekjen e tij fill pas kësaj. Sapo kishte shtënë, N.B. u kthye në veturën ku ishte ulur Sh.U. dhe bashkë me të tjerët u larguan me veturë. F.G., S.A. dhe Sh.U. mbanin armë me vete.

I pandehuri me S.A., Sh.U. dhe B.S. qëllimisht vepruan në bashkëkryerje dhe vranë I.K. siç u përshkrua më lart.

I pandehuri N.B. vetë-deklarua fajtor gjatë shqyrtimit fillestar dhe disa herë më parë e ka pranuar lirisht pjesëmarrjen në vrasjen e I.K. dhe se ishte “aktor” kyç në atë ngjarje fatale. Për mendimin e gjykatës, i pandehuri tregoi të vërtetën. Kjo u konfirmua nga deklaratat e tij

lidhur me rrethanat e lëndës, kur ai u kthye në Kosovë rreth vitit 2009 dhe vendosi të dilte publikisht me akuzat dhe zbulimet prej tij të ngjarjeve në të cilat ai ka pretenduar se ka marrë pjesë gjatë viteve 1999-2000. Faktet e mëposhtme të Akuza, të bazuara në proces-verbalet e shqyrtimit gjyqësor të vitit 2012 në lëndën S.A. e të tjerët (P. Nr. 592/11) dhe dëshmitë e dëshmitarëve, trupi gjykues i shqyrtimit gjyqësor i gjeti të provuara përtej dyshimit të arsyeshëm.

Për më tepër, të gjitha deklaratat e të pandehurit përputhen me dëshmitë dhe provat e tjera në lëndë, domethënë, me deklaratat e D.K. në datën 23 nëntor 2009, të A.S. në datën 3 dhjetor 2009, të B.B. më 31 dhjetor 2009, O.B. më 2 korrik 2010 dhe G.G. më 28 nëntor 2009, 13 shtator 2010 dhe 28 prill 2011, si dhe të K.G. më 7 qershor 2011. Deklaratat e të pandehurit ishin gjithnjë të hollësishme, duke dhënë një panoramë të qartë të rolit / hierarkisë së çdo bashkëkryerësi, dhe nuk ishin të ndryshueshme në thelb. Ato përfshijnë përshkrim të hollësishëm të sjelljes së të bashkëpandehurve dhe japin panoramë të ngjarjes fatale hap pas hapi, nga fillimi deri në fund, kur ata u larguan nga vendi i ngjarjes.

Cilësimi ligjor:

Bazuar në sa më lart, vrasja e lart-përmendur e I.K. u krye me paramendim të qartë, në prani të bashkëshortes së tij, e cila ndenji në oborr pak metra më tutje nga porta e vogël e gardhit, nga i pandehuri me një grup të cilët e kishin parapërgatitur dhe planifikuar vrasjen mjaft kohë përpara. Për më tepër, sulmi u krye në shtëpinë e viktimës ku një person mund të ndjehet i sigurt. I.K. nuk ka pasur asnjë mundësi të vetë-mbrohet. I pandehuri me kryerësit e tjerë ka pasur mjaft kohë për të shqyrtuar dhe për t'u përgatitur për këtë akt. Për këtë arsye, të gjitha kundërshtimet morale ose të tjera janë lënë mënjanë, i pandehuri veproi pa skrupuj. Këta faktorë e bëjnë vrasjen të rëndë.

Në këtë sfond, nisur nga përgatitja dhe planifikimi i vrasjes, siç e ka gjetur të provuar gjykata në këtë lëndë, vrasja është konsideruar nga gjykata si vrasje e rëndë, qartazi e ndarë nga një vrasje më e thjeshtë (Neni 30 paragrafi 1 i LPKSAK-së dhe Neni 22 i KPRSFJ-së, tani veçer e dënueshme nën Nenin 31 dhe Nenin 179 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.4, të KPK-së)

Rregulli i përgjithshëm është se për dënimin është e nevojshme që 1) akti i kryer ishte veprë penale në kohën kur ndodhi, dhe 2) vazhdon të jetë veprë penale edhe në kohën e tashme.

Ligji i zbatueshëm në kohën e vrasjes, Ligji Penal i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës (LPKSAK), e trajton vrasjen në Nenin 30, ku në paragrafin 1 vrasja dënohet me të paktën 5 vjet burgim, kurse paragrafi 2 parashikon të paktën 10 vjet burgim lidhur me disa lloje të caktuara vrasjesh të parashikuara shprehimisht. Neni 30, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.1, trajton vrasjen në mënyrë “brutale” ose “të pabesë”, që në Kodin Penal të tanishëm, KPK (pas 1 JANARIT 2013) në Nenin 179, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.4, cilësohet si mënyrë “mizore” ose “dinake”. Bazuar në faktet e përshkruara më lart, I.K., kur doli përpara të pandehurit N.B., u vra pa mëshirë. Për këtë arsye, kjo vrasje duhet të klasifikohet sipas Nenit 30 paragrafi 2, nën-paragrafi 1 të LPKSAK-së, ose Nenit 179, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.4 të KPK-së, sepse natyra dhe mënyra e kryerjes së vrasjes duhet përshkruar si “mënyrë e pabesë”, si në LPKSAK, dhe “mënyrë dinake”, si në KPK.

Neni 22 i KPRSFJ-së dhe Neni 31 i KPK-së trajtojnë bashkëkryerjen në të cilën elementi qendror është që dy apo më shumë persona së bashku e kryejnë veprën penale duke marrë pjesë në kryerjen e veprës penale ose thelbësisht duke i kontribuar kryerjes së saj në ndonjë mënyrë tjetër. I pandehuri N.B. shkrep armën ndaj I.K., siç u përshkrua më lart, dhe secili prej bashkëkryerësve luajti rolin e vet. S.A. dhe B.S. morën pjesë në vrasje ndër të tjera duke i dhënë mbështetjen e tyre N.B.; Sh.U. kishte dhënë urdhrat për të vrarë I.K. dhe kishte përcaktuar rolet. Ai vetë voziti veturën për tek shtëpia e I.K. dhe priti në veturë kur u ekzekutua vrasja. Pastaj ai i voziti të pandehurit dhe N.B. në largim nga vendi i ngjarjes. Dashja e bashkëkryerjes është përmbushur plotësisht.

Analiza e ligjit më të favorshëm: (afati i burgimit, zbutja e dënimit dhe lirimi me kusht)

Në bazë të Nenit 3 paragrafi 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Kodi Nr. 04/L-082 (KPK), që hyri në fuqi më 1 JANAR 2013, në rast se ligji në fuqi ndryshon para shqiptimit të vendimit të formës së prerë, atëherë ndaj kryesit zbatohet ligji që është më i favorshëm. Për rrjedhojë, në fillim gjykata duhet të përcaktojë se cili ligj është më i favorshëm për të pandehurin në lëndën në fjalë.

I pandehuri N.B. është gjetur fajtor sipas Ligjit Penal të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës (LPKSAK) [PS Nr. 011-25/77], i hyrë në fuqi më 28 qershor 1977, dhe Kodit

Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KPRSFJ), që për mendimin e trupit gjykues janë më të favorshëm për të pandehurin se ligji aktual.

Në bazë të Nenit 30, paragrafi 1 dhe paragrafi 2, nën-paragrafi 1, të LPKSAK-së, lidhur me Nenin 22 (bashkëkryerje) të KPRSFJ-së, kushdo që merr jetën e një personi tjetër do të dënohet me të paktën pesë (5) vjet burgim. Termi burgim prej të paktën dhjetë vjetësh (10) ose dënimi me vdekje (dënimi me vdekje u shfuqizua më 12 dhjetor 1999², pa ndonjë zëvendësim) do të shqiptohet kundër një personi i cili merr jetën e një personi tjetër në mënyrë brutale ose të pabesë. Më 27 tetor 2000, dënimi me vdekje u zëvendësua me dyzet vjet (40) burgim.³

Sot vrasja e rëndë në bashkëkryerje është e dënueshme nga Neni 179, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.4, dhe Neni 31 të KPK-së. Sipas këtij Neni, personi i cili privon nga jeta personin tjetër në mënyrë mizore apo dinake, dënohet me jo më pak se dhjetë (10) vjet burgim ose me burgim të përjetshëm.

Lidhur me zbutjen e dënimit në bazë të Nenit 75, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.3 të KPK -së, gjykata mund ta caktojë dënimin nën kufirin e parashikuar nga ligji, ose të caktojë një lloj dënimi më të butë në rastet kur kryerësi vetë-deklarohet fajtor ose lidh marrëveshje në kushtet e pranimit të fajësisë. Në këto raste, gjykata duhet të marrë parasysh mendimin e prokurorit, mbrojtësit dhe të dëmtuarit lidhur me zbutjen e dënimit, dhe ajo do të këshillohet, por jo kufizohet, nga kufijtë e parashikuar në Nenin 76 të KPK-së, i cili në paragrafin 1, nën-paragrafi 1.1 e zbut dënimin si vijon: *“nëse për veprën penale është paraparë si masë më e ulët dënimi me burgim prej së paku dhjetë (10) vjet, dënimi mund të zbutet deri në pesë (5) vjet burgim”*.

Në bazë të Nenit 42, paragrafi 2, të KPRSFJ-së, gjykata mund ta caktojë dënimin nën kufirin e parashikuar nga ligji, ose të caktojë një lloj dënimi më të butë, kur ajo përcakton se ka rrethana të veçanta lehtësuese që tregojnë se qëllimet e dënimit mund të arrihen me një dënim më të ulët. Neni 43 paragrafi 1, pika 1.1, i KPRSFJ-së thotë se *“kur ka kushte për uljen e dënimit të përmendur në Nenin 42 të këtij Ligji, gjykata e ul dënimin brenda kufirit të mëposhtëm: 1) në rast se një periudhë prej tre ose më shumë vitesh burgim parashikohet si*

² Rregullore e UNMIK-ut 1999/24 neni 1 (5);

³ Rregullore e UNMIK-ut 2000/59 neni 1 (6);

kufiri më i ulët për dënimin për një vepër penale, ky dënim mund të ulet për një periudhë deri në një vit burgim”.

Për këto arsye, bazuar në ato që janë deklaruar dhe në Nenin 42 paragrafi 2 dhe Nenin 43 paragrafi 1, pika 1.1, të KPRSFJ-së, burgimi mund të ulet për një periudhë deri në një vit burgim, që është me i buti për të pandehurin dhe dënimi me burgim mund të caktohet nga 1 vit deri në 9 vjet e 11 muaj.

Lidhur me lirimin me kusht, në bazë të Nenit 9 paragrafi 2 të Ligjit Penal të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, në raste përjashtimore, i dënuari i cili ka vuajtur **një të tretën (1/3)** e periudhës së tij, mund të lirohet nga burgu në rast se plotësohen kushtet nga paragrafi 1 i këtij Neni dhe në rast se rrethana të veçanta që kanë të bëjnë me personalitetin e të dënuarit, tregojnë qartë se objektivi i dënimit është arritur.

Në bazë të Nenit 166 paragrafi 3 të Ligjit për Ekzekutimin e Sanksioneve Penale, të hyrë në fuqi më 1 korrik 1977, në raste përjashtimore lirimi me kusht mund të shqiptohet për të dënuarin i cili ka vuajtur **një të tretën (1/3)** e dënimit me burg, në rast se ekzistojnë kushtet nga paragrafi 2 i këtij Neni dhe në rast se kushtet e veçanta, që kanë të bëjnë me personalitetin e tij, tregojnë se qëllimi i dënimit është arritur.

Në bazë të Nenit 94, paragrafi 2, të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Kodi Nr. 04/L-082 (KPK), personi i dënuar për vepër penale për të cilën është paraparë dënim me të paktën pesë (5) vjet burgim, mund të lirohet me kusht pasi të ketë mbajtur dy të tretat (2/3) e dënimit të shqiptuar. Për vepra tjera penale, personi i dënuar mund të lirohet me kusht pasi të ketë mbajtur **gjysmën (1/2)** e dënimit të shqiptuar.

Bazuar në sa më lart, Ligji Penal i Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës (LPKSAK) dhe Kodi Penal i Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KPRSFJ) janë ligje më të favorshme për të pandehurin në lidhje me afatin e burgimit, zbutjen e dënimit dhe lirimin me kusht, dhe në bazë të Nenit 3 paragrafi 2 të Kodit Penal të Republikës së Kosovës, Kodi Nr. 04/L-082 (KPK), që hyri në fuqi më 1 janar 2013, këto ligje duhet të jenë të zbatueshme për të pandehurin N.B.

Dëshmitë dhe provat e paraqitura dhe të vlerësuara:

I pandehuri N.B. qëndroi pranë deklaratave të tij të dhëna me 30 nëntor 2009, 3 dhjetor 2009 dhe 3 korrik 2013, ku ai përshkroi me hollësi se si u mor nga një veturë me F.G. dhe S.A. dhe pastaj të tre ata vozitën për tek Hotel Victory në Prishtinë, ku takuan Sh.U., D.H. dhe B.S. dhe çfarë ndodhi më vonë. Nga një veturë tjetër ku A.S. ishte ulur me vozitësin e tij, F.G. mori një pistoletë Scorpion me silenciator dhe e solli atë tek N.B. Më pas grupi pa D.H. të voziste për në shtëpinë e I.K. Gjatë vozitjes, Sh.U. dha udhëzimet që I.K. duhej të vritej. N.B., me pistoletën Scorpion në dorë, iu përgjigj pozitivisht. Vetura u parkua 50-100 metra larg shtëpisë së I.K. Sh.U. qëndroi në veturë, ndërsa S.A., B.S., F.G. dhe N.B. shkuan më këmbë deri tek shtëpia. Të katërt mbanin armë. Tek porta, të katërt u pozicionuan, me S.A. në të djathtë të N.B., B.S. në të majtë dhe F.G. prapa N.B. Kur një grua iu përgjigj thirrjes së tyre, ata kërkuan I.K. sepse donin të bisedonin për një pasaportë. Kur I.K. u duk pak jashtë portës në rrugë, identiteti i tij u konfirmua nga S.A. Atëherë N.B., duke përdorur pistoletën që kishte marrë, shkrepiti disa herë, nga 5 deri në 11, në trupin e I.K. Pastaj grupi u kthye në veturën ku Sh.U. ishte ulur dhe u larguan me veturë drejt restorant Qafa, ku të gjithë hëngrën darkë.

Për më tepër, i pandehuri N.B. dha deklaratat e tij para dy trupave gjyqësorë të shqyrtimeve gjyqësore në lëndët e Gjykatës së Qarkut të Prishtinës 1. F.G.(P. Nr. 371/10) dhe 2) S.A. dhe të tjerët (P. nr. 592/11). Në të dy lëndët e lart-përmendura, deklaratat e tij u vlerësuan nga trupat gjykuese si të besueshme dhe të ndërlikuara dhe u shqiptuan dy aktgjykime me dënim.

Dëshmitë dhe provat vërtetuese:

Pala e dëmtuar dhe dëshmitarja D.K. dëshmoi para trupit gjykues në lëndën S.A. dhe të tjerët (P. nr. 592/11) më 2 mars.⁴ Ajo shpjegoi ndër të tjera se bashkëshorti i saj, I.K., para se të dilte në pension, ishte i punësuar nga shërbimi shtetëror i inteligjencës.⁵ Më 6 gusht 1999, katër persona⁶ thirrën tek porta e gardhit rrethues të shtëpisë së tyre në Rrugën xxx xxxx, Nr. xx, dhe kërkuan bashkëshortin e saj të ndjerë, sepse donin të diskutonin për

⁴ Proces-verbal i datës 15 korrik 2013 (nga proces-verbali i datës 2 mars 2012, f. 8);

⁵ Proces-verbal i datës 15 korrik 2013 (nga proces-verbali i datës 2 mars 2012, f. 10);

⁶ Proces-verbal i datës 15 korrik 2013 (nga proces-verbali i datës 2 mars 2012, f. 11 dhe f. 16);

shitjen e një autobusi Zastava.⁷ Ai që foli ishte pak më i shkurtër dhe me flokë të shkurtër.⁸ Pastaj ajo hyri brenda dhe mori bashkëshortin e saj dhe ai doli pak jashtë portës. Pak pas kësaj, ndërsa ajo ndodhej rreth 5 metra më tutje⁹ duke iu drejtuar kumatit të saj, ajo dëgjoji një të shtënë arme dhe më nuk mbante mend asgjë, deri kur ishte në KFOR.¹⁰

Laboratori i krim-teknikës testoi dhe analizoi 6 gëzhoja të gjetura në vendin e ngjarjes dhe një gëzhøjë të dorëzuar nga N.B. Kjo analizë arriti në përfundimin se ishin përdorur 6 plumba të kalibrit 7.65 x 17 mm të tipit Scorpion, kurse gëzhoja e dorëzuar nga N.B. ishte nga një armë e ndryshme, por e kalibrit 7.65 x 17 mm e tipit Scorpion.

Vlerësimi i dëshmive dhe provave:

Deklaratat e N.B. të vitit 2009, si dhe ato të dhëna në fazën e procedurës paraprake në këtë lëndë, vërtetohen në pika thelbësore me dëshmitë e D.K. Ka një kontradiktë ndërmjet asaj që u tha se për çfarë donte të bisedonte grupi jashtë portës me I.K. N.B. dëshmoi se ishte për pasaporta, ndërsa D.K. dëshmoi se ishte për shitjen e një autobusi Zastava. Kjo ishte vrasja e parë e kryer nga N.B.. Normalisht dhe natyrshëm përqendrimi i tij do të ishte në pjesën themelore të asaj që do të ndodhte, domethënë, shtënia me armë mbi viktimën. Prandaj elemente të tjera me peshë më të vogël nuk do të ishin aq në fokus. I pandehuri qëndroi pranë deklaratave që dha gjatë fazës së shqyrtimit gjyqësor.

Analiza forensike arriti në përfundimin se gëzhojat e gjetura ishin nga 2 pistoleta të ndryshme Scorpion. Të gjashtë gëzhojat dhe copëza e një plumbi ishin nga një armë, ndërsa gëzhoja e dorëzuar nga N.B. është nga një armë tjetër. Kjo shpjegohet lehtë me faktin se gëzhoja e dorëzuar nga N.B. duhet të jetë nga një Scorpion tjetër nga Scorpionit që përdori ai kur vrau I.K. Që N.B. dukej se nuk kishte njohje të mirë të armëve të vogla të zjarrit, siç dukej se e kishte D.H., kjo u demonstrua kur N.B. mor në pyetje nga D.H.¹¹ Analiza forensike vërteton dëshminë e N.B. se u përdor një Scorpion dhe se ai shkrepiti nga 5 deri në 11 të shtëna mbi I.K.

⁷ Proces-verbal i datës 15 korrik 2013 (nga proces-verbali i datës 2 mars 2012, f. 11 dhe f. 17);

⁸ Proces-verbal i datës 15 korrik 2013 (nga proces-verbali i datës 2 mars 2012, f. 12 dhe f. 18);

⁹ Proces-verbal i datës 15 korrik 2013 (nga proces-verbali i datës 2 mars 2012, f. 33);

¹⁰ Proces-verbal i datës 15 korrik 2013 (nga proces-verbali i datës 2 mars 2012, f. 11 dhe f. 33);

¹¹ Proces-verbal i datës 15 korrik 2013 (nga proces-verbali i datës 31 tetor 2012, f. 33);

Nuk ka dyshim se I.K. ndërroi jetë fill pas kësaj, si pasojë e të shtënave që u shkrepën mbi të në mbrëmjen e 6 gushtit 1999 dhe askush nuk e ka kontestuar këtë fakt.

Gjykata gjen se deklaratat e N.B. të përshkruara më lart në lidhje me vrasjen e I.K. janë të besueshme dhe bindëse. Po kështu, siç është cekur tashmë më se një herë, për këtë incident ai ka dhënë dëshmi në disa raste, dëshmi që janë të hollësishme dhe të përputhshme. Ato janë të logjikshme dhe pa ndonjë kontradiktë materiale. Gjykata nuk gjen arsye përse N.B.do ta inkriminonte vetveten në këtë mënyrë.

Deklaratat e N.B. në këtë lëndë lidhur me ato që ndodhën, përputhen në pjesët themelore me versionin e D.K., përfshirë atë se rreth orës 9 në mbrëmjen e datës 6 gusht 1999, I.K. e kërkuan katër persona tek porta në derën e vogël të shtëpisë së I.K., dhe se ndodhi vrasja e llojit të ekzekutimit të shpejtë të I.K., e vijuar me arratisjen e menjëhershme të kryerësve nga vendi i ngjarjes. Vetëm N.B. identifikoi kryerësit.

Në këtë sfond dhe nisur nga dëshmitë dhe provat e vlerësuara në tërësinë e tyre, gjykata ka besim në deklaratat e N.B. lidhur me ngjarjen. Për më tepër, duke marrë parasysh provat dhe dëshmitë vërtetuese të cekura më lart, gjykata e gjen ngjarjen e përshkruar nga N.B. si të provuar përtej dyshimit të arsyeshëm.

Vlerësime lidhur me caktimin e masës së dënimit:

Kur trajton më poshtë dënimin e duhur për të pandehurin, gjykata merr parasysh çështjet e përmbajtura në Nenin 3 të KPK-së dhe se vepra penale u krye kur gjithçka u organizua mirë dhe u mbështet nga një grup i fuqishëm që ndër të tjera pati në dispozicion kohën e duhur, armët dhe veturat për të monitoruar palët e dëmtuara shumë kohë më parë, për të përgatitur dhe planifikuar krimet, dhe kapacitetet organizative për t'i ekzekutuar ato me shpejtësi.

I pandehuri i përkiste një grupi të përcaktuar qartë, i përbërë prej të 5 të pandehurve, përfshirë F.G., me një hierarki dhe udhëheqje të përcaktuar mirë dhe që merrte nga A.S. urdhra ose leje për të vepruar. Gjatë ngjarjeve të përshkruara, të gjithë të pandehurit mbanin armë me vete.

Roli dhe dënimi i të pandehurit:

Gjykata e ka gjetur të provuar se N.B. shkrepri të shtënat mbi I.K. dhe e vrau I.K. në bashkëkryerje, siç u përshkrua më lart. Për më tepër, ai mori pjesë me dijeni dhe me dashje dhe kështu veprroi me dashje të drekte, të nevojshme në këtë rast.

Më tej gjykata gjen të provuar se N.B. nuk ishte figurë dominante ose drejtuese. Ai mori pjesë në aktivitetet e grupit.

Përcaktimi i dënimit:

Brenda kësaj kornize, trupi gjykues vlerësoi të gjitha aspektet relevante në dobi dhe në dëm të të akuzuarit.

a) Faktorët lehtësues:

Në bazë të Nenit 42 paragrafi 2 dhe Nenit 43 paragrafi 1, pika 1.1, të Kodit Penal të Republikës Socialiste Federative të Jugosllavisë (KPRSFJ), i zbatueshëm për të pandehurin, trupi gjykues konsideroi si faktorë lehtësues sjelljen e të pandehurit dhe gjendjen familjare të tij (ngjarja ndodhi 14 vjet më parë - 3 fëmijë 8, 10 dhe 12 vjeç, bashkëshortja, i martuar); kohën e tij (një vit) në arrest shtëpiak dhe faktet se që në vitin 2010 ai ka qenë i mbrojtur nga afër. Ai rrëfeu se e ka kryer vrasjen dhe u vetë-deklarua fajtor përpara kësaj gjykate; ai tregoi pendim për atë që kishte bërë dhe shprehu keqardhje për familjen e viktimës. Për më tepër, N.B. priti gjithë këta vjet me durim dënimin e tij dhe konfirmoi në mënyrë të përsëritur version e tij fillestar të fakteve dhe e përsëriti rrëfimin e tij nga fillimi deri në fund në këtë lëndë.

Si faktor tjetër lehtësues duhet vlerësuar ndërlikueshmëria dhe pandryshueshmëria e deklaratave të të pandehurit që nga marrja e parë në pyetje, gjatë fazës së hetimit dhe në shqyrtimin gjyqësor, në lidhje me vrasjen e K. Ai dha emrat e të gjithë bashkëkryerësve, përshkroi rregullat për vete dhe rregulla të tjera. Ai vuri në dukje se kush e dha urdhrin, dhe nuk i ka ndryshuar deklaratat e tij. Në vitet 2011 dhe 2012, bazuar në dëshmitë e tij që u dhanë në dy lëndë, gjashtë bashkëkryerës u dënuan me burgim. Në sajë të qëndrimit të të pandehurit, familja e viktimës, drejtësia dhe shoqëria arritën të mësojnë të vërtetën.

Prandaj, të gjitha rrethanat e cekura më lart u morën si faktor lehtësues kryesor, që rezultoi në një dënim më të ulët kundër të pandehurit.

b) Faktorët rëndues:

Në bazë të Nenit 30 paragrafi 1 dhe paragrafi 2, nën-paragrafi 1, të LPKSAK-së, lidhur me Nenin 22 të KPRSFJ-së, kushdo që merr jetën e një personi tjetër, dënohet të paktën me 5 vjet burgim. Afati i burgimit prej të paktën 10 vjet deri në 40 vjet burgim (që zëvendësoi dënimin me vdekje) do të shqiptohet kundër një personi i cili merr jetën e një personi tjetër në mënyrë brutale ose të pabesë. Rrethanat rënduese të veprimit të të pandehurit janë të dukshme qartësisht në mënyrën e tij të veprimit dhe shpjen në përfundimin se cilësimi ligjor i bërë nga prokurori (vrasje e rëndë dhe jo e thjeshtë) tashmë e pasqyrore atë.

Pas shqyrtimit të të gjithë këtyre faktorëve, trupi gjyqësor i shqyrtimit gjyqësor caktoi dënimin prej 4 vjet dhe 6 muaj burgim.

Koha e kaluar në arrest shtëpiak:

I pandehuri N.B. kishte kaluar në arrest shtëpiak një periudhë prej 12 muajsh, nga 30 nëntori 2009 deri më 29 nëntor 2010. Në bazë të Nenit 365 paragrafi 1, nën-paragrafi 1.5, të KPP-së, koha e kaluar në arrest shtëpiak llogaritet në dënim. Koha pas 29 nëntorit 2010 deri më 19 korrik 2013, kur ai ishte nën masa të posaçme sigurie dhe në mbrojtje nga afër, është pasojë e natyrshme e bashkëpunimit të tij me drejtësinë dhe bazuar në dispozitat ligjore nuk mund të llogaritet si masë e arrestit shtëpiak. Gjykata duhet të theksojë se i pandehuri pranoi vullnetarisht të bashkëpunonte, prandaj kushtet e mbrojtjes së tij ishin vetëm pasojë bazë të veprimit të tij. Sipas Kodit të Procedurës Penale, në dënim mund të llogaritet vetëm koha në arrest shtëpiak dhe asgjë tjetër. Më 26 korrik 2013, mbrojtësi i të pandehurit i paraqiti gjykatës kërkesë për ta llogaritur si arrest shtëpiak periudhën nën masa të posaçme të sigurisë para dënimit.

Siç ceket më poshtë, në bazë të Nenit 9 paragrafi 2 të Ligjit Penal të Krahinës Socialiste Autonome të Kosovës, i dënuari i cili ka vuajtur një të tretën (1/3) e dënimit mund të paraqesë kërkesë për lirim me kusht. I pandehuri u dënua me 4 vjet dhe 6 muaj burgim. Një vit i arrestit shtëpiak (2009-2010) do t'i llogaritet në dënim. Për momentin i pandehuri është

përsëri nën arrest shtëpiak dhe ai do të ketë të drejtën të bëjë kërkesë për lirim me kusht më 20 JANAR 2014.

Kërkesë-padi pronësore:

Nuk u paraqit ndonjë kërkesë-padi pronësore.

Shpenzimet e procedurës penale:

Në bazë të Nenit 453, paragrafi 4 të KPP-së, gjykata e liron të pandehurin nga detyrimi për të paguar në tërësi shpenzimet e procedurës penale siç parashikohet në Nenin 450, paragrafi 2, nën-paragrafët 2.1 deri më 2.6, dhe shpenzimet e procedurës penale do të paguhet nga buxheti i gjykatës.

Përpiluar në gjuhën angleze, gjuhë e autorizuar.

KRYETARE E TRUPIT GJYKUES:

\

Gjyqtarja e EULEX-it

Mariola Pasnik

PROCES-MBAJTËS

Aktgjykimi i arsyetuar u përfundua dhe nënshkrua më ... shtator 2013.

Mjet ligjor:

Në bazë të neneve 380 dhe 381 të KPP-së, personat e autorizuar kanë të drejtën të paraqesin ankesë kundër këtij Aktgjykimi brenda 15 ditëve nga dita që u dorëzohet kopja e këtij Aktgjykimi. Ankesa duhet të ushtrohet në Gjykatën Themelore e Prishtinës.